

Programi IPA 2010 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë

***Asistencë Teknike për Forcimin e Kapacitetit të
Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri për Hartimin e Ligjit
dhe Zbatimin e Legjislacionit Kombëtar të Mjedisit***
(EuropeAid/130987/C/SER/AL)

Formati i Lejes së mjedisit Tipi B

Aktiviteti C.3

Dokumenti Përfundimtar



**Projekti është financuar
nga Bashkimi Evropian**



Titulli i Projektit: Asistencë Teknike për Forcimin e Kapacitetit të Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri për Hartimin e Ligjit dhe Zbatimin e Legjislacionit Kombëtar të Mjedisit
Numri i Projektit: Europe Aid/130987/C/SER/AL;
No. Kontratës. 2011/275-693
Vendi: Republika e Shqipërisë

	Përfitues	Kontraktor
Emri:	Ministria e Mjedisit	Grontmij A/S
Adresa:	Rr. Durrësit, Nr 27, Tiranë, Shqipëri	Granskoven 8 DK-2600 Glostrup
Person i kontaktit:	Ardiana Sokoli	Paolo Bacca
Telefon:	+355 4 2270622	+355 4 2226493
E-mail:	Ardiana.Sokoli@moe.gov.al	Paolo.Bacca@selea.al
Data e Raportit:	Qershor 2014	
Titulli:	Formati i Lejes së mjedisit Tipi B	
Autorët:	Erjola Muka, Bosko Nikov & Kurt Terpgaard-Jensen, Alma Bako	
QA/QC	Paolo Bacca	

Mirënjohje

Ekipi i projektit dëshiron të shprehë mirënjohjen e TIJ për të gjithë personat dhe ekspertët nga të gjitha institucionet dhe palët e interesuara të përfshira në mbledhjen e të dhënave dhe informatave dhe të gjithë personat dhe organet që kanë mbështetur zhvillimin e këtij materiali. Falënderime të veçanta shkojnë për drejtuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Ky raport është përgatitur nga një ekip projekti që punon për Grontmij. Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura në këtë dokument janë vetëm ato të Grontmij dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të merren për të pasqyruar mendimet dhe politikat e Komisionit Evropian.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBETARE E MJEDISIT

MIRATOHET

MINISTRI
(firma, vula)

Nr. ___ Prot

Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrimit të AKM)

Datë _____

AKT MIRATIMI
Leje Mjedisi Tipi B

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisi, AKM propozon dhënien e lejes me kushtet bashkëngjitur për Kërkuuesin si më poshtë:

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTI, Adresa)

ose

b) Personi Fizik (Emri, Mbiemri, Nr. NIPTI, Adresa _____)

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit/impianitit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit")

2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit")

3. Vendndodhja _____

Vlefshmëria e kësaj Leje dhe kushteve të saj fillon në _____ (datë)

Tarifa e paguar në datë _____

për kërkesë për leje mjedisi

ndryshim të kushteve të lejes

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

(emri, mbiemri, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBETARE E MJEDISIT

REFUZOHET

MINISTRI
(firma, vula)

Nr. ___ Prot.

Nr.i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrimit të AKM)

Datë _____

AKT REFUZIMI
Leje Mjedisit Tipi B

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisit, AKM jep mendimin për refuzimin e lejes me argumentimet bashkëngjitur për Kërkuuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTI, Adresa)

ose

b) Personi Fizik (Emri, Mbiemri, Nr. NIPTI, Adresa) _____

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”

2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”

3. Vendndodhja _____

Tarifa e paguar në datë _____

për kërkesë për leje mjedisit

ndryshim të kushteve të lejes

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM
(emri, mbiemri, firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Përmbajtja

Kushti	1	Objekti
Kushti	2	Menaxhimi i Instalimit
Kushti	3	Funksionimi dhe Infrastruktura
Kushti	4	Plani i përputhshmërisë
Kushti	5	Interpretimi
Kushti	6	Njoftimet
Kushti	7	Shkarkimi
Kushti	8	Menaxhimi i Mbetjeve
Kushti	9	Zhurma
Kushti	10	Lëndët e para dhe përdorimi i energjisë
Kushti	11	Monitorimi
Kushti	12	Dokumentimi dhe raportimi tek autoriteti kompetent
Kushti	13	Incidentet dhe veprimet gjatë emergjencave
Kushti	14	Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve

AKRONIME DHE SHKURTIME

DPP	Drejtoria e Punëve Publike
KEE	Komiteti Ekonomik Evropian
KEM	Katalogu Evropian i Mbetjeve
MM	Ministria e Mjedisit
N _{eq}	Niveli Ekuivalent i Tingullit
IPPC	Integrated Pollution Prevention and Control Direktiva e Kontrollit dhe Parandalimit të Integruar të Ndotjes
ISO	Organizata ndërkombëtare për standardizimin
POA	Përbërës Organikë të Avullueshëm
TMD	Teknikat më të Mira të Disponueshme
RESHTN	Regjistri Evropian i Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve
RSHTN	Regjistri Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve
RSHN	Regjistri i Shkarkimit të Ndotjes
RVM	Raporti Vjetor i Mjedisit
SMM	Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
VKSH	Vlerë Kufi e Shkarkimit

KUSHTI 1 – OBJEKTI

1.1 Kjo Leje, dhe kushtet e përcaktuara në të, jepet për veprimtaritë dhe kapacitetet e përcaktuara në kapitullin 2-4 të kërkesës për këtë Leje, ose e modifikuar sipas kushteve të kësaj Leje. Operatori është i autorizuar të zhvillojë veprimtaritë dhe/ose veprimtaritë shoqëruese siç specifikohen në Tabelën 1.1.1 dhe 1.1.2.

TABELA 1.1.1 – Lista e Veprimtarive		
Veprimtaria sipas Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit"	Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar	Kapaciteti kufi i veprimtarisë së specifikuar

TABELA 1.1.2 – Lista e Veprimtarive Shoqëruese	
Veprimtaritë shoqëruese kryesore	Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar

1.2 Operimi, kontrolli, mirëmbajtja e instalimit dhe shkarkimet nga instalimi duhet të kryhen vetëm në përputhje me kushtet e kësaj Leje. Të gjitha programet, planet dhe dokumentet e tjera që do të gjenerohen si rezultat i kësaj Leje do të jenë pjesë përbërëse e saj.

1.3 Ndryshimet në lidhje me funksionimin dhe ndryshimet e konsiderueshme në lidhje me instalimin, që mund të çojnë në një ndryshim në natyrën e shkarkimeve ose rritje të tyre, në sistemin e pakësimit të shkarkimeve, në lëndën djegëse, lëndët e para dhe materialet ndihmëse, produktet ose gjenerimin e mbetjeve, në menaxhimin e instalimit dhe kontrollin, mund të kryhen vetëm pas një kërkesë paraprake me shkrim dhe miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.

1.4 Kjo Leje jepet me qëllim parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes në përputhje me Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe legjislacionin mjedisor në fuqi dhe nuk e përjashton mbajtësin e kësaj Leje nga detyrimet që rrjedhin nga ligjet e tjera në fuqi.

1.5 Instalimi për të cilin është dhënë kjo Leje nuk duhet të vihet në punë derisa të jenë marrë masat e mëposhtme dhe AKM si autoritet kompetent të jetë njoftuar me shkrim për këtë.

1.6 Nëse është e nevojshme, shtoni kushte tjera ose theksoni: nuk kërkohet ASNJË masë para-operacionale shtesë.

1.7 Në këtë Leje, vendndodhje nënkupton zonën e përcaktuar nga vija e kuqe (me ngjyrë të errët) në hartën e mëposhtme (me Koordinatat e vendit sipas Sistemit të Koordinatave Gauss–Krüger: 1942_GK_ZONE_4. Veprimtaritë e autorizuara sipas kushtit 1.1 nuk duhet të shtrihen përtej vendndodhjes, që është zona e përcaktuar në hartën e mëposhtme.

Harta

Harta Topografike me koordinatat e vendit sipas Sistemit të Koordinatave GAUSS KRÜGER: 1942_GK_ZONE_4)

KUSHTI 2 – MENAXHIMI I INSTALIMIT

- 2.1. Të gjitha impiantet, pajisjet dhe mjetet teknike të përdorura për operimin e instalimit për të cilin është dhënë kjo Leje mbahen në kushte të mira funksionimi.
- 2.2. Operatori i pajisur me Leje duhet do të punësojë në vendndodhje si person përgjegjës për instalimin, në përputhje me natyrën e punës, një menaxher me arsimin dhe eksperiencën e duhur. Menaxheri ose një person i caktuar prej tij si person përgjegjës, që të ketë gjithashtu arsimin dhe eksperiencën e duhur, duhet të jenë te pranishëm në vendndodhje vazhdimisht gjatë orarit të operimit të instalimit. Menaxheri/Personi përgjegjës duhet të jenë te disponueshëm për t'u takuar me personat e autorizuar të autoritetit kompetent në çdo kohë.
- 2.3. Operatori duhet të sigurojë që të gjithë punonjësit, të kontraktuarit apo persona të tjerë që kryejnë detyra specifike të jenë të kualifikuar si duhet, të trajnuar dhe të njohur si duhet me kushtet e kësaj Leje.
- 2.4. Regjistri Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (RrShTN)
 - 2.4.1. Jo më vonë se (_____) muaj pas hyrjes në fuqi të rregullave dhe kërkesave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për RrSHTN, mbajtësi i lejes duhet të deklarojë në AKM të dhënat për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve që janë subjekt i këtij Rregjistri.
- 2.5. Dokumentacioni
 - 2.5.1. Operatori duhet të hartojë dhe mirëmbajë dokumentacionin lidhur me menaxhimin e përbërësve të mjedisit për instalimin/impiantin e tij në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe kërkesat e autoritetit kompetent.
 - 2.5.2. Menaxhimi i informacionit mjedisor bëhet nga AKM/ARM sipas legjislacionit në fuqi.
 - 2.5.3. Operatori duhet t'i sigurojë një kopje të Lejes çdo personi detyrat, kompetencat apo përgjegjësitë e të cilit lidhen me ndonjë kusht të kësaj Leje.
- 2.6. Veprimet Korrigjuese
 - 2.6.1. Operatori duhet të hartojë procedurat për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese për rastet kur nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë Leje dhe duhet të përcaktojë përgjegjësitë dhe autorizimet për të filluar investigimet dhe për të ndërmarrë veprimet korrigjuese përkatëse.
- 2.7. Trainimi
 - 2.7.1. Mbajtësi i Lejes duhet të hartojë procedurat për identifikimin e nevojave për trainim dhe duhet të zhvillojë trainimet e duhura për të gjithë punonjësit, puna e të cilëve mund të ketë ndikime të rëndësishme në mjedis. Të dhënat dhe dokumentacioni i trainimeve i vihen në dispozicion autoritetit kompetent.
 - 2.7.2. Punonjësit që kryejnë një detyrë specifike duhet të kenë arsimin, trainimin dhe përvojën e përshtatshme me natyrën e punës.
- 2.8. Përgjegjësia

- 2.8.1. Operatori duhet të sigurojë praninë e një personi përgjegjës në çdo kohë gjatë operimit të instalimit. Personi përgjegjës duhet të jetë i autorizuar dhe i disponueshëm për t'u takuar me persona të autorizuar nga autoriteti kompetent.

2.9. Komunikimi

- 2.9.1. Operatori duhet të hartojë një procedurë për t'i mundësuar publikut marrjen e informacionit lidhur me performancat mjedisore në çdo kohë. Kjo procedurë duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent për miratim së bashku me dokumentacionin e Lejes.
- 2.9.2. Operatori duhet të paraqesë një Raport Vjetor të Mjedisit tek autoriteti kompetent çdo vit kalendarik. Ky raport, duhet të përfshijë minimalisht informacionin e specifikuar në Tabelën 2.9.1 më poshtë (Përmbajtja e Raportit të Mjedisit).

TABELA 2.9.1 – Përmbajtja e Raportit Vjetor të Mjedisit

Programi i Menaxhimit të Mjedisit– raport
Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotjes – raporti për vitin paraardhës
Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotjes – propozimi për vitin ushtrimor aktual
Raport përmbledhës mbi rezultatet për monitorimin e zhurmës
Përshkrim i monitorimit të mjedisit
Përshkrim i monitorimit të zhurmës
Përshkrim i incidenteve/aksidenteve
Raporti për testimin e depozitave dhe tubacioneve
Raport përmbledhës për auditimin e efikasitetit të energjisë, përfshirë raportin e djegies të secilit <i>bojler</i> në instalim, të kryer nga një person/laborator i autorizuar/çertifikuar
Raport për vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të lëndëve të para dhe reduktimin e gjenerimit të mbetjeve
Dokumentacioni përkatës për menaxhimin e mbetjeve
Raporti për progresin dhe propozimet për reduktimin e konsumit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura
Deklaratë mbi masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit (përgjegjësia mjedisore)
Përshkrim i vlerësimit të riskut në terma të përgjegjësisë mjedisore (çdo tre vjet ose më shpesh nëqse kjo bëhet e nevojshme nga kushtet në vendndodhje)
Raporte të tjera të kërkuara nga autoriteti kompetent

KUSHTI 3 – OPERIMI DHE INFRASTRUKTURA

- 3.1.** Operatori duhet të krijojë të gjithë infrastrukturën e duhur në lidhje me këtë Leje, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, përpara fillimit të funksionimit të instalimit.
- 3.2.** Operatori duhet të parashikojë në çdo pikë shkarkimi një vend për pajisjet e marrjes së mostrave ose monitorimit, duke përfshirë edhe pajisjet për mbledhjen e të dhënave dhe komunikimin e tyre siç kërkohet nga autoriteti kompetent.
- 3.3.** Operatori duhet të sigurojë akses të sigurt në të gjitha pikat e marrjes dhe monitorimit të mostrave në vendndodhje si dhe tek ato që ndodhen jashtë saj, në përputhje me kërkesat e autoritetit kompetent ose të inspektoratit të mjedisit.
- 3.4.** Ruajtja në depozita dhe fuçi
- 3.4.1. Sipërfaqet ku janë vendosur depozitat dhe/ose fuçitë duhet të jenë të papërshkueshme dhe rezistente ndaj materialit të ruajtur brenda tyre.
- 3.4.2. Të gjitha zonat me depozita dhe/ose fuçi duhet të jenë minimalisht të mbyllura me argjinatura/rrethime lokale ose në distancë me vëllim të barabartë ose më të madh se vlerat e mëposhtme:
- a) 110% të kapacitetit të depozitës më të madhe që tërhiqet nga graviteti në drejtim të argjinaturës/rrethimit;ose
 - b) 25% të shumës së kapaciteteve të të gjithë depozitave që tërhiqen nga graviteti në drejtim të një argjinature/rrethimi të dhënë.
- 3.4.3. Të gjitha rrjedhjet nga zona e rrethuar duhet të devijohen për t'u mbledhur dhe asgjësuar në mënyrë të sigurt.
- 3.4.4. Çfarëdolloj tubi hyrje ose dalje, valvule, tubat e daljes dhe matësit duhet të mbahen brenda zonës së argjinaturës/rrethuar.
- 3.4.5. Të gjitha argjinaturat/rrethimet duhet të testohen për dëmtime dhe mundësinë e depërtimit të ujit të paktën çdo tre vjet.
- 3.4.6. Operatori duhet të ketë sasi të mjaftueshme të përthithësit në vendndodhje, i cili do të përthithë çdo derdhje në instalim. Përthithësi, pas përdorimit duhet të asgjësohet në mënyrë të përshtatshme për tipin e materialit përthithës.
- 3.4.7. Operatori, duhet të kryejë një vlerësim të riskut në mënyrë që të përcaktojë nëse është e nevojshme të mbahet uji i përdorur për shuarjen e zjarrit përpara paraqitjes së kërkesës për Leje.
- 3.4.8. Nëse përcaktohet që risku ekziston, operatori duhet të përgatisë një Program për Menaxhimin e Riskut, i cili duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent për miratim. Programi duhet të zbatohet tërësisht brenda 3 muajve nga marrja e Lejes.
- 3.5.** Nuk duhet të ketë mbetje të ndërtimit brenda instalimit dhe rrugët duhet të mirëmbahen në mënyrë që të mos shkaktohet gjenerim i pluhurave.

- 3.6.** Të gjithë transportuesit shirit në vend të hapur si dhe ato në ambientet e brendshme me shpejtësi të barabartë ose më të madhe se 3m/s duhet të mbyllen nga sipër.

KUSHTI 4 – PLANI I PËRPUTHSHMËRISË DHE AFATET KOHORE

Operatori duhet të zbatojë Planin e Përputhshmërisë siç përcaktohet në Tabelën 4.1.1. Përmbajtja e Planit të Përputhshmërisë dhe afatet kohore të zbatimit janë paraqitur në tabelën më poshtë:

TABELA 4.1.1 – Plani i Përputhshmërisë						
Kushti Ref.	Veprimtaria e Përputhshmërisë	Kostot e investimit (EUR)	Fillimi i veprimtarisë (date)	Fundi i veprimtarisë (datë)	Rezultatet e veprimtarisë	Metoda e kontrollit
		(Totali)				

SHËNIM

- Veprimtaritë:** Përshkrim i veprimtarisë/veprimtarive që duhet të zhvillohen në mënyrë që të arrihet përputhshmëria e instalimeve me legjislacionin e mjedisit
- Investimet:** Investimet për veprimtarinë
- Fillimi:** Data (muaji/viti) në të cilën është planifikuar fillimi i veprimtarisë
- Përfundimi:** Data (muaji/viti) në të cilën është planifikuar përfundimi i veprimtarisë ose nisja e operacioneve
- Rezultatet e Veprimtarisë:** Duhet të përshkruhen rezultatet specifike (shembull: reduktimi i shkarkimeve)
- Metoda e kontrollit:** Përshkrimi mënyrës sipas të cilës mund të kontrollohet veprimtaria e kryer

TABELA 4.1.2 – Afatet kohore

Kushti Ref.	Veprimtaritë e përputhshmerise	KOSTOT VJETORE – EURO				
		Viti*	Viti*	Viti*	Viti*	Viti*

*Analizat kosto-përfitim të operatorit, përfshirë shpenzimin vjetor të nevojshëm për zbatimin e secilës veprimtari të tabelës 4.1.2.

KUSHTI 5 – INTERPRETIMI

5.1 Vlerat kufi për shkarkimet në ajër duhet të interpretohen si më poshtë:

5.1.1 Monitorimi i vazhdueshëm:

- a) Asnjë vlerë mesatare për 24 orë nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit;
- b) 95% të të gjithë vlerave mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojë vlerat kufi të shkarkimit me më shumë se 20%;
- c) Asnjë vlerë mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit më shumë se dy herë.

5.1.2 Monitorim jo i vazhdueshëm:

- b) Nëse për ndonjë arsye, 30 minuta marrje mostre nuk është e mundur të realizohet, është e nevojshme të aplikohet një periudhë e përshtatshme e marrjes së mostrës, dhe vlerat e përfutuara nuk duhet të tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimit.
- c) Për rrjedhjen, asnjë mesatare ditore nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi.
- d) Për parametrat e tjerë, asnjë vlerë mesatare për 30 minuta nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit.
- e) Pragjet e rrjedhjes në masë duhet t'i referohen shkarkimeve të shprehura në njësi të kg/orë mbi të cilat zbatohet vlera kufi e shkarkimit të përqendrimit.
- f) Vlerat prag të rrjedhjes në masë duhet të llogariten mbi bazën e përqendrimit të përcaktuar si një mesatare në një periudhë të dhënë të shumëzuar me një matje të përshtatshme të rrjedhjes. Asnjë vlerë e përcaktuar në këtë mënyrë nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi të përcaktuar të rrjedhjes në masë.

5.2 Vlerat kufi të përqendrimit për shkarkimet në ajër të përcaktuara në këtë Leje duhet të bazohen në vëllimin e gazit në kushte normale:

5.2.1 Gazet jo të djegshëm:

- a) Temperatura 273K, trysnia 101.3kPa (pa korrigjim për oksigjenin ose përmbajtjen e ujit).

5.2.2 Gazet e djegshëm:

- a) Temperatura 273K, trysnia 101.3kPa, gaz i thatë; 3% oksigjen për lëndët djegëse të lëngshme dhe të gazta, 6% oksigjen për lëndët djegëse të ngurta.

5.3 Vlerat kufi për shkarkimet në ujë:

5.3.1 Matje e vazhdueshme:

- a) Asnjë vlerë e pH nuk duhet të jetë jashtë gamës së specifikuar.
- b) Asnjë vlerë e rrjedhjes nuk duhet të tejkalojë kufirin e specifikuar.

5.3.2 Matja jo e vazhdueshme:

- a) Asnjë vlerë e pH nuk duhet të jetë jashtë gamës së specifikuar.
- b) Asnjë vlerë e temperaturës nuk duhet të tejkalojë vlerën kufi.

- c) Për të gjithë parametrat përveç pH-it, temperaturës dhe rrjedhjes, asnjë mostër mesatare ditore nuk duhet të tejkalojë vlerat kufi të shkarkimit të specifikuar në Shtojcën 3 të Ligjit për Lejet e Mjedisit.
- d) Për të gjithë parametrat përveç pH-it, temperaturës dhe rrjedhjet, asnjë mostër e rastësishme nuk duhet të tejkalojë 1.2 herë vlerat kufi të shkarkimit të përcaktuara në Shtojcën 2.1 dhe /ose 3.1.

5.4 Zhurma

- 5.4.1 Zhurma nga instalimi nuk duhet të kalojë ato nivele të përcaktuara për të nga legjislacioni në fuqi për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Shqipëri. Vlerat kufi të zhurmës duhet të përcaktohen në varësi të vendndodhjes së secilit instalim bazuar në hartat strategjike të zhurmës që ndajnë territorin e Republikës së Shqipërisë për këtë qëllim.

Për Minierat:

5.5 Vibrimet

- 5.5.1 Vibrimet nga shpërthimet duhet të mos çënojnë/dëmtojnë palët e treta në ambientet apo banesat përreth.

KUSHTI 6 – NJOFTIMET

6.1. Operatori, brenda _____(orëve/ditëve) nëpërmjet telefonit, faksit, postës elektronike, duhet të njoftojë AKM dhe Inspektoratin e Mjedisit lidhur me:

- 6.1.1.** Konstatimin e një shkarkimi të çdo substance nga çdo burim potencial, i cili tejkalon ndonjë kufi ose kriter në këtë Leje të specifikuar në lidhje me substancën;
- 6.1.2.** Konstatimin e çdo shkarkimi flurues i cili ka shkaktuar ose mund të shkaktojë ndotje përveç rasteve kur sasia e shkarkuar është kaq e parëndësishme sa do të ishte e pamundur të shkaktonte ndotje;
- 6.1.3.** Konstatimin e çdo keqfunksionimi, defekti ose avarie të impiantit ose teknikave që kanë shkaktuar ose mund të kenë potencialin të shkaktojnë ndotje; dhe
- 6.1.4.** Çdo aksident që ka shkaktuar ose mund të ketë potencialin të shkaktojë ndotje.

Në njoftim, operatori duhet të tregojë qartë datën dhe kohën e incidentit, detajet e ngjarjes dhe masat për të minimizuar çdo shkarkim.

6.2. Operatori duhet të njoftojë me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur, për secilin nga rastet e mëposhtme:

- 6.2.1.** Ndërprerjen e përhershme të operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja;
- 6.2.2.** Ndërprerjen e operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja për një periudhë, që ka gjasa të tejkalojë (____) vit/vjet; dhe
- 6.2.3.** Rifillimin e operimit të ndonjë pjese ose të gjithë instalimit për të cilin është dhënë Leja pas një ndërprerje të njoftuar sipas pikës 6.2.2.

6.3. Operatori duhet të njoftojë me shkrim autoritetin kompetent lidhur me çështjet e mëposhtme, brenda (____) ditëve nga ndodhja e tyre:

- 6.3.1.** Çdo ndryshim në emrin tregtar të operatorit, emrin e regjistruar ose adresën e zyrave të regjistruara, në përputhje me të dhënat që rezultojnë në Ekstraktin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR);
- 6.3.2.** Cdo ndryshim në të dhënat e shoqërisë mëmë të Operatorit (përfshirë detajet e shoqërisë mëmë kur vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-Operator dhe Operatori është bërë shoqëri bijë)¹;
- 6.3.3.** Çdo hap i ndërmarrë me synimin që Operatori të shkojë drejt administrimit, të lidhë një marrëveshje vullnetare ose të shkojë drejt procedurave të likuidimit.

¹ Për çdo informacion shtesë, lutemi konsultoni Pjesën e VII “Grupimi I shoqërive”, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

KUSHTI 7 – SHKARKIMET

7.1. SHKARKIMET NË AJËR

7.1.1. Shkarkimet në ajër nga pika(t) e shkarkimit të specifikuar në Tabelën 7.1.1 duhet të dalin vetëm nga burimi(et) e specifikuar në atë Tabelë. (Referohuni numrit të referencës së Planit të vendndodhjes)

Tabela 7.1.1: Pikat e shkarkimit në ajër

Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	A1
Vendndodhja e pikës së shkarkimit (përdor Sitemin e Koordinatave Gauss–Krüger: 1942_GK_ZONE_4:	X: Y:
Burimi	
Sasia e emetuar: maksimumi ditor:	m ³
Rrjedhja maksimale në një orë:	m ³ /h
Lartësia minimale e shkarkimit:	m mbi tokën

Përsëriteni për pikat e tjera të shkarkimit

7.1.2. Kufijtë për shkarkimet në ajër për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 7.1.2 nuk duhet të tejkalohen në periudhën e përshtatshme kohore të treguar në këtë Tabelë.

TABELA 7.1.2: Vlerat kufi të shkarkimeve në ajër

Parametrat	Referenca e pikës së shkarkimit A1-1	
	Deri në (datën)*	Nga (data)**

* VKSH para zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

** VKSH bazuar në TMD të arritura pas zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

Shto rreshta dhe/ose kolona nëse është e nevojshme

Për çdo pikë shkarkimi tabelë e veçantë

7.1.3. Operatori duhet të kryejë monitorimin dhe analizën për çdo shkarkim/parametër të listuar në Tabelën 7.1.3 nga pikat e shkarkimit dhe të paktën në frekuencat e specifikuar në atë Tabelë. Analiza duhet të kryhet me aparate/mjete të kalibruar ose në rastin e monitorimit jo të vazhdueshëm matjet duhet të kryhen nga një ekspert ose laborator i certifikuar.

TABELA 7.1.3 - Monitorimi i parametrave nga pika(t) e shkarkimit		
Parametri	Pika e shkarkimit (A1-1)	Metodat /teknikat
	{Specifiko shpeshtësinë/frekuencën}	–
	{ Specifiko shpeshtësinë }	–
	{Specifiko shpeshtësinë}	–

Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi

Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.

- 7.1.4.** Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit, monitorimit dhe kontrollit duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen, ndërkohë që janë në përdorim, dhe të dhënat e regjistruara përkatëse të kalibrimit dhe mirëmbajtjes duhet të mbahen në vendndodhje dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi nga personeli i autorizuar i autoritetit kompetent. Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit duhet të funksionojnë gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprimtarive, përveç rasteve kur është rënë dakord me autoritetin kompetent për zgjidhje alternative.
- 7.1.5.** Raporti përmbledhës mbi shkarkimet duhet t’i dërgohet Inspektoratit të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit çdo (____) muaj dhe duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 7.1.6.** Të gjitha shkarkimet nga instalimi nuk duhet të kenë erë të pakëndshme sulmuese jashtë kufirit të instalimit.
- 7.1.7.** Të gjitha shkarkimet në ajër, përveç avullit ose avull uji të kondensuar, nuk duhet të kenë pikëza, mjegull dhe tym të vazhdueshëm.
- 7.1.8.** Të gjitha shkarkimet nuk duhet të kenë tym të dukshëm. Nëse për arsye mirëmbajtje, shkaktohen shkarkime tymi për shkak të rindezjes nga i ftohti, kjo nuk duhet të ndodhë për një periudhë më të gjatë se 20 minuta në çdo periudhë prej 8 orësh dhe kur të jenë marrë të gjithë hapat praktikë për të minimizuar shkarkimin.
- 7.1.9.** Shkarkimet e përgjithshme të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) nuk duhet të tejkalojnë 20% të tretësit të përdorur, nëse konsumi tejkalon 5t/vit.
- 7.1.10.** Operatori, brenda gjashtë muajve nga data e lëshimit të kësaj Leje, duhet të përgatisë një plan të përshtatshëm të menaxhimit të tretësve organikë dhe t’ia paraqesë autoritetit kompetent për miratim.
- 7.1.11.** Operatori, brenda gjashtë muajve nga data e lëshimit të kësaj Leje, duhet të përgatisë një program për identifikimin, monitorimin dhe pakësimin e shkarkimeve fluruese në ajër dhe paraqesë tek autoriteti kompetent për miratim. Programi duhet të zbatohet tërësisht brenda 3 muajve nga data e miratimit.
- 7.1.12.** Operatori duhet të sigurojë që veprimtaritë në vendndodhje të zbatohen në mënyrë të tillë që shkarkimet në ajër dhe (ose) erërat e pakëndshme të mos shkaktojnë dëmtime të rëndësishme të mjedisit përtej kufijve të instalimit.

7.2. SHKARKIMET NË KANALIZIME

7.2.1. Shkarkimet në kanalizime nga pika(t) e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 7.2.1 duhet të dalin vetëm nga burimi(et) e specifikuara në këtë Tabelë.

TABELA 7.2.1 Pikat e shkarkimit në kanalizime		
Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	K1	
Koordinatat e pikës së shkarkimit në Sitemin e Koordinatave Gauss–Krüger: 1942_GK_ZONE_4	X:	Y:
Burimi		
Kanalizimi		
Vëllimi i emetuar	Maksimumi ditor	m ³
	Maksimumi në orë	m ³

7.2.2. Kufijtë për shkarkimet në kanalizime për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 7.2.2 nuk duhet të tejkalohen në periudhën kohore të treguar në këtë Tabelë.

TABELA 7.2.2 Vlerat kufi të shkarkimit në kanalizime		
Parametri	Pika e shkarkimit K1	
	Deri në (datën)*	Nga (data)**
Rrjedhja (m ³ /h)		
pH		
Temperatura (°C)		
Toksiciteti		

* VKSH para zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

** VKSH bazuar në TMD të arritura pas zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

*Shto rreshta dhe/ose kolona nëse është e nevojshme
Për çdo pikë shkarkimi tabelë e veçantë*

7.2.3. Operatori duhet të kryejë monitorimin dhe analizën e parametrave të listuar në Tabelën 7.2.3 nga pikat e shkarkimit dhe të paktën në frekuencat e specifikuara në atë Tabelë.

TABELA 7.2.3- Kërkesat e monitorimit për kanalizimet (nga dita/muaji/viti)		
Parametri	Pikat e shkarkimit (K1)	Metodat /teknikat
	{specifiko frekuencën}	-
	{specifiko frekuencën}	-
	{specifiko frekuencën}	-
Oksigjen i shpërbërë		-
Azot Amoniaku si N mg/l		
Rrjedhja ditore m3		
Niveli maksimal i rrjedhjes m3/orë		-
Përbërës organikë të fosforit		-

Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi

Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.

- 7.2.4.** Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit, monitorimit dhe kontrollit duhet të kalibrohen dhe mirëmbahen, ndërkohë që janë në përdorim, dhe të dhënat e regjistruara përkatëse të kalibrimit dhe mirëmbajtjes duhet të mbahen në vendndodhje dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi nga personeli i autorizuar i autoritetit kompetent. Të gjitha pajisjet e reduktimit/trajtimit duhet të funksionojnë gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprimtarive, përveç rasteve kur është rënë dakord me autoritetin kompetent për zgjidhje alternative.
- 7.2.5.** Raporti përmbledhës për shkarkimet duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 7.2.6.** Operatori duhet të paraqesë raportin përmbledhës tek autoritetet e autorizuar të higjenës dhe të shëndetit publik.
- 7.2.7.** Përveç ujit sanitar, asnjë lloj tjetër uji nuk duhet të shkarkohet në kanalizime.
- 7.2.8.** Ujërat e ndotur nuk duhet të përmbajnë tretës organikë (përfshirë tretësit organikë të klorinuar) që mund të çojnë në krijimin e avujve shpërthyes brenda kanalizimeve.
- 7.2.9.** Operatori nuk duhet të shkarkojë lëndë të lëngshme ose lëndë të tjera që mund të ngecin ose ngurtësohen në temperaturën mesatare të ujit të kanalizimit ose mund të krijojnë gazra që marrin flakë ose që janë shpërthyes ose acide, alkaline apo substanca të tjera në përqendrime që mund të shkatërrojnë tubacionet e kanalizimeve dhe pajisjet e tyre ose t'i dëmtojnë ato në mënyrë tjetër.

- 7.2.10.** Nuk lejohe të shkarkohet në kanalizime lëndë në përqendrime të cilat do të ishin të rrezikshme për shëndetin e personelit të mirëmbajtjes ose të cilat do të ndikonin në trajtimin biologjik në fazat e ardhshme të trajtimit të ujërave të ndotura.
- 7.2.11.** Nuk duhet të shkarkohen në kanalizime substanca, në përqendrime të cilat pas hollimit fillestar në një mjedis pritës mund të rezultojnë të dëmshme për jetën ujore.
- 7.2.12.** Operatori duhet t'i krijojë mundësi personelit të autorizuar nga autoriteti kompetent/inspektorati që të inspektojë, kontrollojë ose testojë çdo operacion ose pajisje në çdo kohë (moment) të arsyeshme në lidhje me ujërat e ndotur ose të marrë një mostër uji që është objekt i kushteve të kësaj Leje.
- 7.2.13.** Ndalohet shkarkimi i substancave të cilat shkaktojnë reaksione kimike ose që shkaktojnë krijimin e ndërmjetësve me ndikime të rëndësishme negative në mjedis.

7.3. SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË (PËRVEÇ SHKARKIMEVE NË KANALIZIME)

- 7.3.1.** Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë nga pika(t) e shkarkimit të specifikuar në Tabelën 7.3.1 duhet të dalin vetëm nga burimi(et) e specifikuar në atë tabelë.

TABELA 7.3.1: Pikat e shkarkimit në ujë

Numri i referencës i pikës së shkarkimit:	U1
Koordinatat e pikës së shkarkimit në Sitemin e Koordinatave Gauss–Krüger: 1942_GK_ZONE_4:	X: Y:
Burimi	
Uji i pritur	
Rrjedhja :	
Maksimumi ditor:	m3/h
Maksimumi në orë:	m3/h

- 7.3.2.** Kufijtë për shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë për parametrin/parametrat dhe pikën/pikat e shkarkimit të përcaktuara në Tabelën 7.3.2 nuk duhet të tejkalohen në periudhën kohore të treguar në këtë Tabelë.

TABELA 7.3.2 Vlerat kufi të shkarkimit në ujërat sipërfaqësorë		
Parametri	Pika e shkarkimit U1	
	Deri në (datën)*	Nga (data)**
Rrjedhja (m ³ /h)		
pH		
Temperatura (°C)		
Toksiciteti		
PE		

* VKSH para zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

** VKSH bazuar në TMD të arritura pas zbatimit të Planit të Përputhshmërisë

Shto rreshta dhe/ose kolona nëse është e nevojshme

Për çdo pikë shkarkimi tabelë e veçantë

- 7.3.3.** Operatori duhet të kryejë inspektime vizuale ditore të shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore. Të dhënat e inspektimit duhet të mbahen dhe të vihen në dispozicion autoritetit kompetent për inspektimin.
- 7.3.4.** Monitorimi i ujërave të shkarkuara tek ujërat sipërfaqësore duhet të kryhet siç është përcaktuar në Tabelën 7.3.4 mbi Monitorimin e Shkarkimeve në Ujërat Sipërfaqësorë. Raporti duhet të jetë pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Shkarkimeve. Operatori duhet të marrë mostra dhe të monitorojë kanalën e kullimit {specifiko} në një frekuencë {specifiko}.

TABELA 7.3.4 - Monitorimi i parametrave nga pika (t) e shkarkimit në ujërat sipërfaqësorë		
Parametri	Pika e shkarkimit (TU 1)	Metodat/teknikat
	{Specifiko shpeshtësinë}	-
	{Specifiko shpeshtësinë}	-
	{Specifiko shpeshtësinë }	-

Një grup tabelash për pajisjet e reduktimit të shkarkimeve në çdo vend shkarkimi

Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmërisë, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kushtet e reja kanë hyrë në fuqi.

- 7.3.5.** Nuk duhet të ketë asnjë shkarkim në ujë nga instalimi i pajisur me Leje mjedisi të ndonjë substance për të cilën nuk ka vlera kufi të specifikuara në Tabelën 7.3.2 (përveçse në një përqendrim i cili nuk është më i madh se sa përqendrimi i mjedisit ekzistues).
- 7.3.6.** Në rast të ndonjë konstatimi të ndotjes, mbajtësi i Lejes duhet të:
- Kryejë menjëherë investigimin në mënyrë që të identifikojë dhe izolojë burimin e ndotjes.
 - Përgatisë masat për parandalimin e ndotjes dhe reduktimin e pasojave nëse ndodh një ndotje e tillë.
 - Njoftojë autoritetin kompetent dhe inspektoratin brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

7.4. UJËRAT NËNTOKËSORË DHE TOKA

7.4.1. Nuk lejohet të shkarkohet asnjë lëndë ndotëse në tokë ose në ujërat nëntokësorë nën vendndodhjen e instalimit.

7.4.2. Mjetet për mbrojtjen e tokës dhe ujërave nëntokësorë

Operatori duhet të zbatojë gjithashtu masat e mëposhtme:

- a) Testi i parë i papërshkueshmërisë së rrethimit/argjinaturës duhet të përfundohet brenda datës (dita/muaji /viti).
- b) Ngarkimi dhe shkarkimi i lëngjeve dhe lëndëve të tjera që mund të ndikojnë tek ujërat nëntokësorë, duhet të kryhet në zonat e përcaktuara në kërkesë për këtë qëllim dhe që janë të mbrojtura kundër rrjedhjeve ose derdhjeve.
- c) Të gjitha bashkimet dhe valvulat për transportin e të gjitha materialeve, duhet të kontrollohen rregullisht (inspektim vizual javor), me përjshatim të ujit të pastër për të cilin nuk ka mënyrë të parashikuar për kontrollin e shkarkimit.
- d) Të gjitha këto inspektime duhet të dokumentohen dhe të dhënat e regjistruara duhet të mbahen në vendndodhje dhe duhet t'i vihen në dispozicion personave të autorizuar për inspektim.

KUSHTI 8 – MENAXHIMI I MBETJEVE

8.1. Asgjësimi dhe përdorimi i mbetjeve duhet të kryhet vetëm sipas përcaktimeve të Tabelës 8.1.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe Tabelës 8.1.2 të Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të tjera në këtë Leje. Tipet e tjera të mbetjeve, me përjashtim të atyre të specifikuara në tabela, nuk duhet të asgjësohen/trajtohen në vendndodhje ose jashtë saj pa informuar më parë Ministrinë dhe pa marrë miratim me shkrim nga Ministria. (Nëse mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme nuk ruhen ose trajtohen në vendndodhje, është e nevojshme që në shtojcën përkatëse të shkruhet se "mbetjet nuk trajtohen/asgjësohen në këtë vendndodhje").

TABELA 8.1.1 Asgjësimi/trajtimi i mbetjeve të rrezikshme				
Mbetja	Numri i Katalogut	Trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Ripërdorimi, riciklimi ose trajtimi në vendndodhje	Metoda e asgjësimit /trajtitimit në vendndodhje

Shtoni rreshta nëse është e nevojshme

TABELA 8.1.2 Asgjësimi/trajtimi i mbetjeve të tjera				
Mbetja	Numri i Katalogut	Trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Ripërdorimi, riciklimi ose trajtimi në vendndodhje	Metoda e asgjësimit /trajtitimit jashtë vendndodhjes

Shtoni rreshta nëse është e nevojshme

8.2. Operatori, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, duhet të trajtojë dhe ruajë mbetjet siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 8.2.1 për ruajtjen e Mbetjeve ose ndryshe siç është rënë dakord me shkrim nga autoriteti kompetent. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë paracaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim.

TABELA 8.2. 1: Mbetjet e ruajtura në vendndodhje			
Përshkrim i mbetjes	Vendndodhja e vendit të ruajtjes	Mënyra e ruajtjes	Kushtet e ruajtjes

Shtoni rreshta nëse është e nevojshme

- 8.3. Mbetjet e larguara nga vendndodhja për asgjësim/trajtim duhet të transportohen vetëm nga një kontraktor i autorizuar dhe i pajisur me Lejet/licensat përkatëse. Operatori, në përputhje me kushtet e kësaj Leje, duhet të rikuperojë dhe asgjësojë mbetjet siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 8.3.1 mbi rikuperimin dhe asgjësimin, apo ndryshe siç është rënë dakord me shkrim nga autoriteti kompetent.

Tabela 8.3.1: Rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve		
Përshkrimi	Dokument	Data e marrë

Shtoni rreshta nëse është e nevojshme

- 8.4. Amendamentet e e kërkesave të marrëveshjes, klasifikimit, trajtimit dhe asgjësimit duhet të kryhen vetëm me anë të një marrëveshje paraprake nga autoriteti kompetent.
- 8.5. Paketimi, etiketimi duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kombëtare, europiane dhe standardet e tjera..
- 8.6. Nuk lejohet përzierja e mbetjeve të rrezikshme të njëjës kategori me mbetje të rrezikshme nga një kategori tjetër, me përjashtim të rasteve kur kjo është miratuar me shkrim nga autoriteti kompetent.
- 8.7. Të gjitha të dhënat e regjistruara që lidhen me menaxhimin e mbetjeve duhet t'i vihen në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent. Këto të dhëna duhet të përmbajnë si minimum elementët e mëposhtëm:
- a) Sasinë dhe kodet KEM (EWC) për mbetjen në Tabelën 8.1.1 mbi *Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të Rrezikshme* dhe Tabelës 8.1.2 mbi *Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të tjera në këtë Leje*.
 - b) Emrin e grumbulluesit të mbetjeve dhe transportuesit dhe detajet e Lejeve/licencave/autorizimeve të tyre (përfshirë autoritetin lëshues).
 - c) Detaje rreth instalimit për asgjësimin/trajtimin përfundimtar të mbetjeve dhe pajtueshmërinë e instalimit për asgjësimin/trajtimin e mbetjeve dorëzuara, detajet e Lejes/licencës/autorizimit dhe detajet për autoritetin lëshues.
 - d) Konfirmimin me shkrim për pranimin dhe asgjësimin/trajtimin të çdo dërgese mbetjesh jashtë vendndodhjes.
 - e) Detaje për çdo dërgesë jashtë shtetit për qëllim të trajtimit të përcaktuar si "të listës së Gjelbër" në bazë të Rregullores KEE Nr. 259/1993 dhe amendamenteve të saj. Arsyetimi për klasifikimin duhet të përbëjë një pjesë integrale të dokumentacionit.
 - f) Të dhëna për të gjitha dërgesat e refuzuara.
 - g) Detaje për të gjitha përzierjet e miratuara të mbetjeve në përputhje me kushtet e pikës 8.6.
- 8.8. Një kopje e dokumentacionit mbi menaxhimin e mbetjeve duhet t'i dorëzohet autoritetit kompetent si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.

Për Minierat:

- 8.1.** Mbetjet. Një plan për menaxhimin e mbetjeve duhet të dorëzohet në AKM brenda (____) muajsh pas datës së lëshimit të lejes.

KUSHTI 9 – ZHURMA DHE VIBRACIONET

- 9.1. Operatori duhet të propozojë shpeshtësinë, metodologjinë dhe kohën e matjeve.
- 9.2. Dokumentacioni mbi kushtet dhe rezultatet e matjes duhet t'i vihet në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent ose inspektoratit të mjedisit në çdo kohë të arsyeshme. Raporti përmbledhës mbi këto të dhëna të regjistruara siç përcaktohet në Tabelën 9.1.1 duhet të jetë pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.

Tabela 9.1.1 Vlerat kufi të zhurmës				
Vendndodhja	Koordinatat (Sistemi Gauss–Krüger 1942_GK_ZONE_4)	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Natë
	X			
	Y			
	X			
	Y			

Nëse pika e shkarkimit mbulohet nga Plani i Përputhshmëri, tabela duhet të ribëhet me shtesën e kushteve të reja. Tregoni datën në të cilën kanë hyrë në fuqi kushtet e reja.

- 9.3. Veprimtaritë në vendndodhje nuk duhet të rezultojnë me nivele të rritura të zhurmës ose të tejkalojnë vlerat e mëposhtme (Leq, t):

Ditën: _____ dB (A)

Në mbrëmje: _____ dB (A)

Natën: _____ dB (A)

- 9.4. Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës gjatë operimit të instalimeve.
- 9.5. Operatori duhet të _____ (kushte specifike për vibracionet/shpërthimet).

KUSHTI 10 – LËNDËT E PARA DHE SHFRYTËZIMI I ENERGJISË

- 10.1.** Operatori duhet të kryejë auditimin e efikasitetit të energjisë brenda një viti nga lëshimi i kësaj Leje. Operatori duhet të konsultohet me autoritetin kompetent mbi natyrën dhe qëllimin e auditimit dhe të hartojë një program auditimi. Programi i auditimit duhet t'i paraqitet organit kompetent për miratim të paktën një muaj përpara kryerjes së tij. Kopja e raportit të auditimit duhet t'i vihet në dispozicion autoritetit kompetent në vendndodhje, dhe një përmbledhje e gjetjeve të tij duhet t'i paraqitet atij si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit. Auditimi i efikasitetit të energjisë duhet të kryhet në përputhje me intervalet e përcaktuara nga autoriteti kompetent.
- 10.2.** Operatori duhet të identifikojë çdo mundësi për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe rekomandimet duhet të bëhen pjesë e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Kushtin 2.
- 10.3.** Operatori duhet të identifikojë potencialin për reduktim të sasisë së ujit të përdorur në vendndodhje. Operatori duhet të paraqesë një raport të hollësishëm lidhur me progresin dhe propozimet për reduktimin e ujit të përdorur dhe shkarkimin e ujërave të ndotura tek autoriteti kompetent, si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit.
- 10.4.** Operatori duhet të përgatisë vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të lëndëve të para në të gjitha proceset, me theks të veçantë në reduktimin e mbetjeve të gjeneruara.

KUSHTI 11 – MONITORIMI

11.1. Operatori duhet të kryejë marrjen e mostrave, të bëjë analiza, matje, testime dhe kalibrimin e pajisjeve, siç përcaktohet në Tabelat si vijon:

Tabela 7.1.3: Monitorimi i shkarkimeve në ajër

Tabela 7.2.3: Monitorimi i shkarkimeve në kanalizime

Tabela 7.3.4: Monitorimi i shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore

11.2. Nëse mundësia e matjes së një parametri ndikohet nga përzierja përpara shkarkimit, ky parametër duhet të matet përpara momentit të përzierjes, pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.

11.3. Të gjithë monitorët automatikë dhe pajisjet e marrjes së mostrave duhet të funksionojnë në çdo moment (me përjashtim të periudhave gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimit) gjatë operimit të një instalimi, me përjashtim të rasteve kur autoriteti kompetent ka miratuar marrjen e mostrave ose monitorimin alternativ. Në rast të avarive ose mosfunksionimit të ndonjë pajisje të monitorimit të vazhdueshëm, operatori duhet të informojë autoritetin kompetent sa më shpejt të jetë e mundur dhe të vendosë një pajisje alternative. Përdorimi i pajisjeve alternative jashtë rasteve emergjente është i mundur vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.

11.4. Pajisjet për monitorimin dhe analizën duhet të përdoren dhe mirëmbahen në mënyrë që të tregojnë saktë shkarkimet dhe/ose çlirimet.

11.5. Ndryshimi i shpeshësisë, metodës dhe qëllimit të monitorimit është i mundur vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent, bazuar në analizën e rezultateve të testimit.

11.6. Operatori duhet do të sigurojë akses të sigurt dhe të përherëshëm për të mundësuar marrjen e të gjitha mostrave dhe monitorimet që do të kryhen në lidhje me pikat e shkarkimit që lidhen me:

- a) Shkarkimin në ajër
- b) Rrjedhjet pas largimit nga instalimi
- c) Burimet e zhurmës në vendndodhje
- d) Vendet e përcaktuara për asgjësimin e mbetjeve në vendndodhje
- e) Shkarkimet në ujërat sipërfaqësore

11.7. Operatori duhet të sigurojë akses të sigurt në të gjitha pikat e tjera monitoruese sipas kërkesës së autoritetit kompetent.

11.8. Marrja e mostrave dhe analizat duhet do të kryhen siç përcaktohen në standardet ISO.

KUSHTI 12 – DOKUMENTIMI DHE RAPORTIMI

- 12.1.** Operatori duhet të bëjë regjistrimin e të dhënave për të gjitha rastet e marrjes së mostrave, matjeve, testimeve, kalibrimeve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të monitorimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Leje.
- 12.2.** Operatori duhet do të hartojë dhe të mbajë dhëna për çdo incident që mund të ndikojë në funksionimin e rregullt dhe që mund të paraqesë një rrezik për mjedisin.
- 12.3.** Operatori duhet të përgatisë një raport për çdo ankesë që ka të bëjë me mjedisin që lidhet me operimin e instalimit. Çdo raport duhet të përmbajë informacion mbi kohën dhe datën e ankesës, emrin e ankuesit dhe natyrën e ankesës. Operatori duhet të mbajë gjithashtu një kopje të përgjigjeve ndaj secilës ankesë. Brenda një muaji nga marrja e ankesës, operatori duhet të paraqesë një raport mbi ankesën tek autoriteti kompetent. Përmbledhja mbi numrin dhe natyrën e ankesave duhet të përfshihet në Raportin Vjetor të Mjedisit.
- 12.4.** Forma e raportit duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kompetent. Këto raporte duhet të mbahen në vendndodhje të paktën (____)vjet dhe të jenë të disponueshme në rast inspektimi.
- 12.5.** Raportet mbi të gjitha të dhënat e regjistruara, rastet e marrjes së mostrave, të matjeve, analizave, kalibrimit dhe mirëmbajtjes siç përcaktohet në Tabelën e mëposhtme 12.5.1 Dokumentimi i të dhënave dhe Raportimi tek Autoriteti Kompetent duhet t'i dorëzohen autoritetit kompetent jo më vonë se (data dhe formati i raportit).

Tabela 12.5.1. Dokumentimi i të dhënave dhe raportimi

Paraqisni raporte të përfunduara tek:

Adresa:

Raporte	Shpeshtësia e raportimit	Data e paraqitjes së raportit
Monitorimi i shkarkimeve në ajër		
Monitorimi i shkarkimeve në ujëra		
Ujë sipërfaqësor		
Ankesa (nëse ka)		
Propozimi për regjistrin e shkarkimit të ndotjes		
Programi i Monitorimit të Zhurmës		
Programi i Menaxhimit të Mjedisit me shtojcë për objektivat dhe detyrat		
Raporti Vjetor i Mjedisit		

- 12.6.** Me kërkesë të autoritetit kompetent, operatori duhet të paraqesë gjithashtu informacionin mjedisor në lidhje me këtë Leje në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit kompjuterik të autoritetit kompetent.
- 12.7.** Të gjithë raportet duhet të miratohen nga menaxheri i përgjithshëm i instalimit ose nga menaxheri teknik i autorizuar nga menaxheri i përgjithshëm i instalimit.
- 12.8.** Përshkrime me shkrim të procedurave për kontrollin e operimeve që mund të jenë të lidhura me Lejen, duhet t'i vihen në dispozicion nëpunësve të autorizuar të inspektoratit ose të autoritetit kompetent në vendndodhje në çdo kohë të arsyeshme.
- 12.9.** Në varësi të rezultateve, autoriteti kompetent mund të ndryshojë shpeshtësine dhe qellimin e raportimit.

KUSHTI 13 – INCIDENTET DHE VEPRIMET GJATË EMERGJENCEVE

- 13.1.** Brenda (____) muajve nga dhënia e kësaj Leje, operatori duhet të miratojë një politikë për parandalimin e aksidenteve, në mënyrë të veçantë ato që mund të kenë ndikim në mjedis.
- 13.2.** Brenda (____) muajve nga dhënia e kësaj Leje, operatori duhet të përcaktojë procedurat për t'iu përgjigjur emergjenceve, të cilat duhet të përfshijnë çdo situatë të rrezikshme që mund të krijohet në vendndodhje. Këto procedura duhet të përfshijnë masat që synojnë minimizimin e ndikimit në mjedis të këtyre situatave.
- 13.3.** Politikat dhe procedurat duhet të vlerësohen çdo vit dhe amendohen sipas nevojës.
- 13.4.** Operatori gjatë përgatitjes së politikës për parandalimin e aksidenteve duhet të marrë në konsideratë edhe parashikimet e ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe veçanërisht dispozitat mbi përgjegjësinë mjedisore.

KUSHTI 14 – ÇMONTIMI, REHABILITIMI DHE KONTROLI PAS NDËRPRERJES SË OPERACIONEVE

- 14.1.** Brenda (____) muajve nga data e marrjes së Lejes, operatori duhet të përgatisë dhe paraqesë për miratim tek AKM një plan të detajuar dhe kostot përkatëse për çmontimin ose mbylljen e instalimit.
- 14.2.** Planet për çmontimin dhe rehabilitimin duhet të rishikohen çdo vit dhe të paraqiten për miratim në AKM.
- 14.3.** Pas mbylljes së instalimit ose të një pjese të tij për më shumë se (____) muajsh ose ndërprerjes së planifikuar të operacioneve në të gjithë instalimin ose në një pjesë të tij, operatori duhet të kryejë rehabilitimin në përputhje me planin e miratuar nga AKM.
- 14.4.** Garanci Bankare ose Sigurim me qëllim vënien paraprakisht në dispozicion të fondeve për kompensimin e dëmit në përputhje me metodat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për sigurimin e fondeve të tilla.